

Zyra Kombëtare e Auditimit e Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK) dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) zhvillojnë trajnim mbi shkrimin e raporteve të auditimit dhe mbi strategjinë e komunikimit

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe mbështetjes teknike të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD), në datat 19-21 mars, në ambientet e Hotel Tirana International, u zhvillua trajnimi mbi shkrimin e raporteve të auditimit dhe mbi strategjinë e komunikimit.

Trajnimi u realizua nëpërmjet asistencës teknike nga ekspertët e lartë në fushën e komunikimit të NAO UK, z. Benjamin Peters, Drejtor i Komunikimit me Jashtë, z. Dan Gluckeman, Menaxher i Lartë për Komunikimin Dixhital dhe znj. Natalie Low, Menaxhere e Lartë e Auditimit.

Ekspertët e NAO UK nënvizuan rëndësinë e një strategjie efektive komunikimi për Institucionet Supreme të Auditimit, ndërveprimi me Parlamentin, duke u fokusuar në hartimin dhe shpërndarjen e informacionit në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, hartimin e buletineve, për të rritur transparencën dhe ndërveprimin me publikun dhe aktorët institucional, përdorimin e mjeteve dixhitale, për të forcuar ndikimin e mesazheve publike dhe për të rritur efektivitetin e komunikimit institucional.



Trajnimi mbi shkrimin e raporteve të auditimit, i udhëhequr nga znj. Natalie Low, pati në fokus përmirësimin e aftësive për shkrimin e raporteve të auditimit. Përmes sesioneve praktike dhe



ushtrimeve, të zhvilluara në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku u trajtuan në mënyrë konkrete teknikat mbi përcaktimin e fushës së auditimit dhe gjetjeve kryesore, strukturës logjike në raportim dhe teknikat për një raportim efektiv.

Në përfundim të trajnimit, nga pjesëmarrësit dhe nga trajnuesja, znj. Low, u theksua rëndësia e përdorimit të teksteve të thjeshta në raportim si dhe paraqitjes grafike e të dhënave në mënyrë

të përmbledhur, për të ofruar një pasqyrë të plotë dhe të qartë të punës audituese dhe gjetjeve përkatëse.

Ky trajnim përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të audituesve dhe stafit të institucionit për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji të qëndrueshme komunikimi, duke rritur ndikimin dhe besueshmërinë e tyre në raport me publikun dhe partnerët institucional.